



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-  
01.Nr. zyrtar/ 2025

### **Procesverbal**

#### **Takimi i III-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025**

**Më 1.07.2025**

Në takim prezantuan:

**Sabedin Vishi**, Nënkyrytar i Komunës

**Emrush Llinovci**, Stacioni i Policisë-Kaçanik

**Fidaim Fazliu-KBI**

**Fatmir Qaka**, EVSB

**Bujar Bajra**-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

**Elmihane Malsiu**-HANDIKOS

**Naim Hysa**-Kryqi i Kuq Komunal

**Jashar Selimi**-Këshilli i Prindërve

**Ylber Tusha**-Përfajqsues i bizneseve

**Shemsedin Abazi**-KLSP

**Albestrim Rexhepi** - FSK

Mbledhjen e kryesoi Nënëkryetari i Komunës me këto pikat të rendit të ditës .

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën në mes dy takimeve .
- 3.Roli i qytetarëve në parandalimin e vandalizmit .
- 4.Përmirësimi i ndriqimit dhe infrastrukturës .
- 5.Vlerësimi i kapaciteteve egzistuese - bashkëpunimi me OJQ .
- 6.Të ndryshme .

#### **1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

-Procesverbal i miratohet nga të pranishmit .

#### **2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën në mes dy takimeve**

-Për gjendjen e sigurisë për periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Policisë i cili e cilësoi si të qetë dhe stabile .

Një problematikë e kahmotëshme ka qenë Parku Nacional por që në një takim të përbashkët me Drejtorin rajonal dhe me Ministrinë jemi dakorduar që ta kemi si punë sekondare edhe po shpresojmë se do të ndryshoj për mirë kjo çështje .

Në përgjithësi situata e sigurisë është e mirë dhe nuk kemi ndonjë rast që në masë të madhe ka prish rendin dhe qetësin publike .

Jemi në sezonin e verës dhe pritet një fluks i madh i automjeteve dhe njerëzve por që ne me kohë i kemi marrë masat për parandalim të çdo dukurie që rrrezikon sigurinë qytetare, kuptohet duke bashkëpunuar me të gjithë akterët .

**Ramadush Osmani** - Bashkëpunimi do të vazhdoj me Policinë por që kam vërejtje që për një informacion shum të thjesht nuk ka nevojë një zyrtarë i lart të ftohet në Polici .

Për këto informacione ju mundë ta organizoni një zyrtarë Policor që të i kontaktoj zyret Komunale për të marrë këto informacione .

**Emrush Lalnovci** - Nëse kërkohet nga Prokurori që të intervistojmë një zyrtar Komunal ne vetëm e zbatojmë urdhërin e tij , por që kuptohet që ne do e shohim përshtatjen e kohës për të mos penguar zyrtarin në kryerjen e obligimeve që ka gjat orarit të punës .

#### **3.Roli i qytetarëve në parandalimin e vandalizmit**

**Nënëkryetari** - Vandalizmi është një dukuri që nënkupton dëmtimin e pronës publike dhe private dhe për parandalimin e kësaj dukurie kontribut mundë të jep qytetarët .

Brengosëse është fakti se qytetarët hezitojnë të jepin informacione , mungon vetëdijësimi por që një arsyesh mundë të jetë që informacionet nuk janë konfidenciale .

**Emrush Lalinovci** - Informacionet duhet me qenë konfidenciale dhe në raste të tilla nëse qytetarët dhe ju hezitoni të jepni ndonjë informacion unë personalisht ua jap edhe numrin tim të telefonit dhe në çdo kohë jam i gatshëm për bashkëpunim dhe informacioni do të jetë konfidencial .

**Fidaim Fazliu** - Vandalizmi në disa objekte është më i theksuar e sidomos në ato vende që popullata është larguar . E kam fjalën për objektet fetare siq janë Xhamitë të cilat shfrytëzohen nga disa persona për veprimtarit e tyre .

Kjo dukuri ka prekë edhe Shkollat por edhe punktet shëndetësore që janë në vise rurale dhe përkështetje te organet e sigurisë dhe institucionet Komunale për një përkujdesje më të madhe .

Një kërkesë e imja për institucionet Komunale është që hapësirat publike të mirëmbahen .

E kam fjalën për krasitjen e drunjëve që i kanë mbuluar edhe shenjat e komunikacionit e gjithashtu krijimin edhe të hapësirave tjera publike që e lehtësojn qarkullimin e lirë të automjeteve dhe qytetarëve

Një kërkesë e kahëmotëshme e imja ka qenë për rregullimin e një trotuari para Xhamisë së qytetit por që deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë rreth kësaj çështje.

**Nënkryetari** - Mungon vetëdijësimi i qytetarëve që objektet publike siq janë shkollat , punktet shëndetësore , xhamitë por edhe hapësirat publike duhet të ruhen ngase ato janë ndërtuar për to .

Ne si Komunë shpesh bëjm edhe riparimin e tyre por që kjo dukuri po përsëritet prap .

**Emrush Lalinovci** - Është e pamundur që ne si polici të i ruajm të gjitha këto objekte por që kushdo që i kontrollon dhe i mirëmbanë në rast të ndonjë problemi që hasin mundë të na informojnë .

**Elmihane Malsiu** - Pajtohem me atë që duhet një vetëdijësim i qytetarëve për ruajtjen e pronës publike ngase ata i rregullon Komuna por që qytetarët i shfrytëzojnë .

Objekti i HANDIKOS - it është pranë palestrës dhe unë shohë që disa të rinjë e keqëpërdorin hapësirën e jashtme të palestrës duke bërë vepra shkatërruese mbi pronën publike .

Krahas vetëdijësimit është mirë të vendosen edhe shenja që të kujdesemi për atë ambient të krijuar .

**Ramadush Osmani** - Krahas vetëdijësimit duhet me pasë edhe penalizime për ata që dëmtojnë pronën publike .

#### **4.Përmirësimi i ndriçimit dhe infrastrukturës**

**Nënkryetari** - Sa i përket sistemit të ndriçimit dhe infrastrukturës Komuna jonë mund të them se qëndron mirë por që në mirëmbajtje disa herë mundë të kemi vonesa e kjo vjenë si pasojë e ligjit të prokurimit që na e pamundëson përzgjedhjen e kompanisë kualitative ngase kërkohet kompania që konkuron me çmim më të ulët .

**Ramadush Osmani** - Është lehtë të investohet por që vështirë të mirëmbahen . Ne si Komunë për mirëmbajtje kemi ndarë mjete që është një shumë e madhe .

Aktualisht kemi 95 rrjete të ndriçimit publik me afér 4000 drita në gjithë territorin që kemi shtrit sistemin e ndriçimit dhe shpesh ndodh që kemi ankesa të qytetarëve për dëmtim të ndriçimit .

Përkujdesje më të madhe ne si Komunë më shum i kushtojmë rëndësi mirëmbajtjes rrugore ngase rrugët janë ato që qytetarët i shfrytëzojnë për nevojat e tyre .

Kërkesat e qytetarëve për mirëmbajtje janë të mëdha në krahasim me bugjetin Komunal që e kemi .

Në kuadër të Komunës ne kemi një komision që shqyrton kërkesat e qytetarëve dhe aty ku është e arsyeshme ne me kapacitetet tona intervenojmë .

Për mirëmbajtjen e parqeve dhe rrugëve ne kemi një kontratë me një kompani dhe mund të them se në kët drejtim qëndrojm mirë ndërsa shqetësuese e shoh mungesën e vullnetarizmit qytetarë .

**Naim Hysa** - Rruja për në Stagovë nëpër Dushkajë është bërë e rrezikshme për shkakë të daljes së degëve të drunjve në rrugë e që problemi më i madh qëndron tek vendet që janë pronë private.

Për kët ne si lokalitet i fshatit Stagovë kërkojmë një zgjidhje sa i përket kësaj çështje.

**Ramadush Osmani** - Shum shpejt kemi me fillu me krasitjen e drunjve që kanë dalë në rrugë dhe besoj se edhe në kët rrugë do të intervenohet .

**Shemsedin Abazi** - Në rrugën „Idriz Seferi” ka ndodhë një shpërthim i një uji dhe ka filluar të i dëmtoj kubëzat e vendosura .

A do të intervenohet në sanimin e kësaj gjendje ngase pasojat mundë të jenë edhe më të mëdha .

**Ramadush Osmani** - Arsyja e mos intervenimit në këtë pjesë ka qenë magjistralja e myllur dhe si pasojë e shpërthimit të ujit ka qenë edhe qarkullimi i automjeteve të rënda që e ka shkaktuar kët prishje dhe tash pasi që është lëshuar magjistralaja prioritet do të jetë kjo rrugë .

##### **5.Vlerësimi i kapaciteteve egzistuese - bashkëpunimi me OJQ .**

**Nënkryetari** - Sa i përket bashkëpunimit me OJQ mundë të them se është mjaft i mirë duke u bazuar edhe në koordinimin që kemi në realizimin e programeve të ndërsjellta .

Ne si Komunë për çdo vit bëjmë subvencionimin e OJQ - ve dhe për çdo thirrje publike ne formojm komision vlerësues ku nga 5 anëtar të komisionit 2 janë nga shoqëria civile të cilët aplikojnë për kët komision .Për vlerësimin e kapaciteteve ne mundë të japim ndonjë mendim por vlerësimin e tyre mund ta bëj vet OJQ përmes organeve të sajë ndërsa ne vetëm mundemi të monitorojmë aktivitetet e tyre duke u bazuar edhe në kontratën e nënshkruar nga dy palët .

**Elmihane Malsiu**- Si përfaqësuese e një organizate jo qeveritare mundë të them se bashkëpunimin me Komunën në implementim të projekteve e kemi të mirë por që përkrahja duhet të jetë edhe më e madhe për HANDIKOS .

Komuna na ka ndihmuar në krijimin e kushteve për punë përmes një objekti që e kanë ndërtuar për organizatën por që ne si organizatë kemi nevojë edhe për mbështetje më të madhe financiare

Është e vërtet që shum organizata jo qeveritare në komunën tonë nuk kanë kapacitete të mjaftueshme andaj duhet të mendohet në ngritjen e kapaciteteve për organizatat.

**Naim Hysa** - Ka organizata që aplikojnë në thirrje të ndryshme për subvencionim ndërsa kapacitetet mbredha organizatës janë shum të dobta .

Ne si organizatë e Kryqit të Kuq nuk jemi subvencionuar asnjëher nga Komuna por që nuk mundemi me thanë që nuk kemi pasur bashkëpunim .

#### 6.Të ndryshme

**Jashar Selimi** - Dua të i ngrisë disa çështje sa i përket sigurisë në përgjithësi .

Një dukuri jo e mirë që është bërë aktuale është shpejtësia dhe zhurma e motoristëve nëpër rrugë

Çështja e vandalizmit është prezente dhe për kët çështje duhet një bashkëpunim në mes qytetarëve dhe Policisë dhe kërkoj nga Policia që informacionet të janë konfidenciale .

Edhe unë si përfaqësues i Organizatës së Invalidëve të luftës së UÇK - së në bazë të informacioneve që kam nuk jemi subvencionuar asnjëher nga Komuna por që bashkëpunim në shënimin e datave të rëndësishme kemi pasur çdo herë që është kërkuar .

**Nënkyetari** - OJQ - të duhet ta kenë një vet organizim të mbrendshëm mbredha organizatës dhe të dijnë të menagjojnë organizatën duke kërkuar fonde edhe nga donator tjerë .

Ne si Komunë me kët bugjet që kemi bëjm thirrje për subvencionim dhe këto subvencione përmes komisionit të vlerësimit i ndajmë përgjat vitit . Tani kemi edhe ligjin për sponsorizim që ua mundëson OJQ - ve gjetjen e donatorëve .

**Emrush Lalnovci** - Nuk përjashtohet mundësia për rrjedhje të informacioneve por që ne si Polici çështjen e konfidencialitetit e kemi për obligim që ta respektojmë .

**Bujar Bajra** - Jemi duke hyrë në dy muaj ku mundë të ballafaqohemi me dukurinë e zjarreve dhe ne si Drejtori e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave kemi marrë masat paraprake për parandalim .

Është brengosëse mos formimi i një grupei vullnetarësh në Komunën tonë që do të ndihmonte në çdo emergjencë që mundë të ndodhë .

Shërbimi i zjarrëfiksëve është në gjendje gatishmërie për intervenime por që sfidë janë kapacitetet dhe numër jo i mjaftueshëm i personelit .

**Fatmir Qaka** - Çështja e ujit të pijshëm ka me qenë sfidë në vehte në kët sezonë dhe pyetja ime është se a janë ndërmarrë masa për tejkalim të kësaj sfide .

**Nënkyryetari - Bifurkacioni menagjohet nga niveli qendrorë e për fat të keq nuk është bërë asnjë hap në shtim të kapacitetit të ujit por që edhe nuk ka gadishmëri për komunikim e bashkëpunim në zgjidhjen e kësaj çështje edhe pse kemi informacione se ujë ka mjaftueshëm por menagjimi është i dobët .**

### **REKOMANDIMET**

- 1.Të ruhet konfidencialiteti i informacioneve nga policia
- 2Të mirren masa rigorozë ndaj atyre personave që shfaqin vandalizëm në pronën publike e private
- 3.Përkujdesje më e madhe ndaj objekteve të cilat kan shuar veprimtarinë(xhamitë,shkollat,punktet shëndetsore etj)
- 4.Të iniciohet organizim vulltarë në mes institucioneve dhe qytetarëve për aktivitete të ndryshme
- 5.Të bëhet krasitja e drunjëve të cilët pengojnë qarkullimin e automjeteve në disa rrugë
- 6.Të punohet më shumë në ngritjen e kapaciteteve dhe shtim të fondeve për OJQ



Procesmbajtës

Fatmir Qaka